

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtari Valon Totaj – kryetar i kolegjit, Gani Avdiu e Rrustem Thaqi – anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Ngrohtorja e Qytetit (N.Q.) “Termokos“, Sh.A, Prishtinë, të cilën e përfaqëson i autorizuari F.SH., jurist i diplomuar, kundër të paditurit S.J. nga Prishtina, rruga “.....”, lam..., nr..., për shkak të borxhit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.260/09, të datës 26.11.2013, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 06.11.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit S.J. nga Prishtina, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.260/09, i datës 26.11.2013, **VËRTETOHET**, përveq pjesës për llogaritjen e kamatës, e cila **NDRYSHOHET** dhe gjykohet sikurse për mjetet e deponuar mbi një vit pa destinim të caktuar e cila paguhet në bankat komerciale të Kosovës, duke e llogaritur atë nga dita e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë 26.11.2013, e deri në pagesën definitive.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.260/09, të datës 26.11.2013, e ka miratuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit N.Q.”Termokos”, me seli në Prishtinë dhe e ka detyruar të paditurin S.J. nga Prishtina, që paditësit në emër të shfrytëzimit të ngrohjes qendrore për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2006 t’ia paguaj shumën prej 112.65 euro me kamatë 3.5% nga dita e marrjes së aktgjykimit e gjer në pagesën definitive bashkë me shpenzimet procedurale në shumën prej 30 euro, të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kanosjen e përmbarimit ligjor. Në pikën II të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar pjesa e kërkesëpadisë mbi shumën 112.65, e deri në 452.14 euro.

Kundër këtij aktgjykimi, i padituri në afatin ligjor ka paraqitur ankesë duke mos i përmendur pretendimet ankimore me propozim që Gjykata e Apelit në bazë të fakteve dhe provave materiale që po prezantohen të merr vendim të drejtë dhe të hedhë poshtë aktgjykimin C.nr.260/09, të datës 26.11.2013.

Paditësi nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit është e **pabazuar**.

Nga shkresat e lëndës rezulton se tani paditësi (asokohe kreditori) me datën 17.05.2007, ka paraqitur propozim për përmbarim në Gjykatën Komunale në Prishtinë kundër këtu të tani paditurit (askokohe debitorit), andaj e njëjta gjykatë me aktvendimin Ekz.nr.1414/07, të datës 22.05.2007, e ka lejuar propozimin për përmbarim për shkak të mos përmbushjes së detyrimit lidhur me pagesën e borxhit nga i padituri S.J. nga Prishtina, për shumën e borxhit në vlerë prej 452.14 euro.

Kundër aktvendimit mbi lejimin e propozimit për përmbarim me datën 18.12.2009, i padituri ka ushtruar kundërshtim, për shkak se kreditori N.Q. "Termokos", borxhin për ngrohje me shifër EDA 1414/07, të datës 02.04.2007, për periudhën - muajt 1,2,3,4,10,11,12, të vitit 2005; dhe për muajt 1, 2, 3, 4, 10, 11, 12, të vitit 2006 në shumën prej 452,14 euro, kreditori nuk e ka kryer shërbimin për atë që po e kërkon, andaj ka kërkuar nga gjykata që padinë e paditësit ta hedh poshtë si të bazë duke u mbështetur në dëshmitë që i ka paraqitur.

Duke vepruar në lidhje me kundërshtimin e tani të paditurit, gjykata e shkallës së parë ka marr konkluzion E.da.nr.1414/2007, të datës 31.12.2008, përmes së cilit e ka shfuqizuar aktvendimin për lejimin e përmbarimit E.da.nr.1414/2007, të datës 22.05.2007, ndërsa propozimin e kreditores tani e ka konsideruar si padi.

Pas kësaj gjykata e shkallës së parë me datën 26.11.2013, ka mbajtur seancë publike, ku e njëjta pas përfundimit të seancës gjyqësore ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimin e të gjitha shkresave të lëndëve pastaj ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.260/09, të datës 26.11.2013, me të cilën e ka miratuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit N.Q. "Termokos", me seli në Prishtinë, duke vendosur më decidivisht sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Në arsyetim të aktgjykimit ka theksuar nga kartela e konsumatorit e vitit 2005-2006, e lëshuar me datën 23.04.2007, rezulton se i padituri ka ngelur borxh ndaj paditëses për shfrytëzimin e ngrohjes qendrore për muajt si në padinë e paditësit. Gjykata kartelën e konsumatorit të dorëzuar si provë nga ana e paditëses e ka pranuar si të besueshme pasi që kartela e ka cilësinë e dokumentit publik sepse është lëshuar nga N.Q. "Termokos", në Prishtinë, nga e cila kuptohet se i padituri është faturuar rregullisht nga data 01.02.2005, e gjer me datën 01.01.2007 dhe se gjatë kësaj periudhe i padituri nuk është furnizuar me ngrohje në total 117 dite ndërkaq vlera e ditëve pa ngrohje e zbritur është në shumën 289,04 euro kurse për pages kanë ngelur 452.14 euro. Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se e vlerëson kundërshtimin e të paditurit për sa i përket parashkrimit të një pjese të borxhit kontestues dhe ka gjetur se në rastin konkret borxhi

është parashkruar në pjesën me të madhe dhe atë për muajt 1, 2, 3, 4, 10, 11 dhe 12 të vitit 2005, si dhe për muajt 1, 2, 3 dhe 4 të vitit 2006, ndërkaq nuk është parashkruar për periudhën 01.10.2006 - 31.12.2006, në shumën prej 112.65 euro, ngase padia është paraqitur në gjykatë me datën 17.05.2007, ndërsa borxhi është i faturuar për periudhën 01.01.2005 deri 31.12.2006 që do të thotë se në rastin konkret, meqenëse sipas nenit 378 par.1 pika.1 të LMD-së së zbatueshme për këtë rast, borxhi për ngrohjen parashkruhet për një vit, është parashkruar borxhi për përudhën 01.01.2005, e gjere me 31.04.2006.

Gjithashtu gjykata e shkallës së parë ka theksuar se i padituri ka marrë pjesë në shqyrtimin kryesor, si dhe në deklaratimet e tij e ka pranuar se ka pas ngrohje të dobët në korridor dhe në kuzhinë të banesës së tij ndërsa në dy dhomat e fjetjes nuk ka pasur ngrohje, mirëpo nuk ka ofruar prova që do të kundërshtonin pretendimet e palës paditëse, për çka gjykatës i rezultoj si i provuar fakti se i padituri i ka borxh paditësit shumën e lartcekur, të cilën edhe e ka obligim që t'ia paguaj asaj. Mbi bazën e të lartcekurave e duke u bazuar në dispozitat e nenit 262 të LMD-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Lidhur me shpenzimet procedurale gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka mbështetur në dispozitën e nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për shkeljet që i referohen gjendjes faktike pasi që gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit ka administruar provat e paraqitura nga palët ndërgjyqësore me të cilat ka vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si në arsyetim të aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë i është përmbajtur dispozitës së nenit 160 paragrafi 4 i LPK-së, në atë mënyrë që ka përshkruar kërkesat e palëve, faktet që kanë parashtruar palët, provat e propozuara dhe të administruara, si dhe mënyrën se si janë vlerësuar provat e administruara.

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë së paditëses, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se përfundimi i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm bazuar në ligj, ngase se me nenin 262 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve parashihet se *“kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij”*. Në kuptim të këtyre dispozitave

rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret drejtë është zbatuar edhe e drejta matariale, e për të cilat shkaqe kjo gjykatë kujdeset zyrtarisht, përveq për pjesën e kamatës së gjykuar, për të cilën Gjykata e Apelit gjen se është bërë zbatimi i gabuar i të drejtës materiale, andaj në këtë pjesë gjykata e ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar vetëm sa i përket aplikimit të lartësisë së kamatës, duke e gjykuar kamatën sikurse për mjetet e deponuara mbi një vit e pa destinim të caktuar, e cila paguhet në bankat komerciale të Kosovës, e cila do të llogaritet nga dita e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë, e deri në pagesën definitive, në kuptim të nenit 277 të LMD.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) dhe (e), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2146/14, me datën 06.11.2018

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari
Valon Totaj